AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ), Tetor 2026


23.11.2026
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin tetor 2026.

Eksportet e Kosovës shënojnë rritje prej 35,3% në tetor 2026, duke rritur mbulueshmërinë e importit në 17,8%

Eksporti i mallrave në muajin tetor 2026 kishte vlerën 124,2 milion Euro, ndërsa importi 699,3 milion Euro që është një rritje prej 35,3 % për eksport, si dhe një rritje prej 12,5 % për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025.


Të dhënat nga tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar prej 8,5 % në muajin tetor 2026, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2025, gjegjësisht në vlerë prej 575,1 milion Euro, krahasuar me deficitin prej 530,0 milion Euro në vitin 2025. Eksporti mbulon importin me 17,8 %.

Qarkullimi e mallrave në tregtinë e jashtme




Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 23,3 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 20,6 % e përbëjnë produktet minerale; 10,7 % e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 8,7 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 8,1 % e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; etj.

Eksportet sipas sektorëve të grupeve kryesore në vlerë



Ndërsa, sipas të dhënave të grupeve kryesore të importit: 18,6 % e përbëjnë produktet minerale; 12,3 % e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 11,5% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 11,0 % e përbëjnë mjetet e transportit; 9,3 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; etj.

Importet sipas sektorëve të grupeve kryesore në vlerë



Eksportet dhe importet sipas vendeve në vlerë dhe %

(në mijë Euro)

Vendet	Tetor - 2025		Tetor - 2026	
	Vlera	%	Vlera	%
	Eksportet (FOB)			
Gjithsej	**91,808**	**100.0**	**124,184**	**100.0**
27 vendet e BE_së	31,064	33.8	35,342	28.5
Cefta	39,608	43.1	65,923	53.1
Të tjera	21,136	23.0	22,919	18.5
	Importet (CIF)			
Gjithsej	**621,807**	**100.0**	**699,297**	**100.0**
27 vendet e BE_së	284,332	45.7	283,627	40.6
Cefta	75,487	12.1	84,769	12.1
Të tjera	261,988	42.1	330,901	47.3

Eksportet dhe Importet e Kosovës në vendet e BE-së

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 35,3 milion Euro, ose rreth 28,5 % e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 13,8 %. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (9,5 %), Holanda (2,9 %), Italia (2,2 %), etj.

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 283,6 milion Euro, ose 40,6 % e importeve të përgjithshme, me një rënie prej (-0,2 %). Importet me pjesëmarrje me të lartë ishin nga: Gjermania (12,8 %), Greqia (5,7 %), Italia (4,5 %), etj.

Eksportet dhe Importet e Kosovës me vendet e CEFTA-s

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 65,9 milion Euro, ose 53,1 % të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 66,4 %. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Shqipëria (28,7 %), Maqedonia e Veriut (11,4 %), Serbia (6,7 %), Mali i Zi (4,2 %), etj.

Importet nga vendet e CEFTA-s arritën në 84,7 milion Euro, ose 12,1 % të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 12,3 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Maqedonia e Veriut (5,2 %), Serbia (3,1 %), dhe Shqipëria (2,5 %).

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Eksportet dhe Importet e Kosovës me vendet e tjera

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera arritën në 22,9 milion Euro, ose 18,5 %. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin: Zvicra (9,0 %) dhe Turqia (2,4 %).

Importet e Kosovës me vendet e tjera arritën në 330,9 milion Euro, ose 47,3 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Kina (15,5 %) dhe Turqia (10,6 %).

Për më shumë informata, lidhur me Statistikat e Tregtisë së Jashtme për muajin tetor 2026, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/ForeignTrade